

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 98 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, neni 14 paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.56/15), pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1371/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/10 datë 10.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJ Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 98 paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe nenit 14 paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit (RTRR), të mënyrës që në kuadër të shërbimit programor televiziv, transmetuar më 4 mars 2025, në edicionet premier dhe reprizat e emisioneve „Proekt zdravje“(Projekti shëndeti), „Gradime da trae“(Ndërtojm të qëndrojnë) dhe „Zgotveno nad oblaci“(Gatuajmë mbi re), janë transmetuar reklama pop/ap me ekran të ndarë në të cilën periudha e përcaktuar prej së paku 15 minutash nuk respektohet.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1371/1 datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJ Shkup, në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij Aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RTRR.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratim llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente të kryej mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore si dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medis (transmetues) ndërmerr masë – vërejtje publike në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratura në bazë të Ligjit të njëjtë si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 98 paragrafi (2) të LSHMAAV, rregullat për teknikat e reja të reklamimit i përcakton Agjencia, në pajtim me nenin 14 paragrafi (4) të RTRR, ndërmjet dy sekuecencash të reklamave me ekran të ndarë duhet të kalojë një periudhë prej së paku 15 minutash.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore me datë 27 mars 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, transmetuar më 4 mars 2025, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelje e nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (4) të RTRR.

Gjegjësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se më 4 mars 2025, Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, në edicionet premierë dhe repriza të emisioneve, „Gradime da trae“(Ndërtojmë të qëndron) dhe „Zgotveno nad oblaci“(Gatuar mbi re), janë transmetuar pop-ap/reklama me ekran të ndarë ku periudha e përcaktuar prej së paku 15 minutash nuk respektohet.

Shkelj nga pika 1 e këtij Aktvendim, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1371/1 datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup me datë 28.03.2025, dërgoi Shkresë ark.nr.10-1371/2 datë 28.03.2025, ku dorëzoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1371/1 datë 27.03.2025, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtua Këshilli të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RTRR. Shkera është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 01.04.2025. Në afatin e parashikuar Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, nuk ka dorëzuar deklaram me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RTRR. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.04.2025, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, t'i shqiptoj masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht vnga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 98 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, neni 14 paragrafi (4) të RTRR, pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1371/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/10 datë 10.04.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RTRR, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 10.04.2025 miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron Shoqërinë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup dhe urdhëron që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RTRR. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1371/1 datë 27.03.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.